



Datë: 23.01.2026
Numër Protokolli: 373/2026

A.nr.1503/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1503/2025, të datës 09.07.2025, të parashtruar nga ankuesja, E.B, kundër organit të punësimit: Zyra e Presidentes, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1503/2025, e datës 09.07.2025, e parashtruar nga ankuesja E.B lidhur me procedurën e pranimit më numër reference: RN00017594. **Anulohet** në tërësi me procedura e pranimit më numër reference: RN00017594, pozita e punës Zyrtar i Lartë për Organizimin e Eventeve, Zyra e Presidentes së Kosovës.

II. Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1503/2025, të datës 09.07.2025, e parashtruar nga ankuesja E.B lidhur me procedurën e pranimit më numër reference: RN00017639, pozita e punës Udhëheqës i Divizionit për Marrëdhënie me Publikun, Zyra e Presidentes së Kosovës.

III. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore në Zyrën e Presidentes së Kosovës që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendim, të ndërmerr veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi ashtu siç përcaktohet në pikën I të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, E.B (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017594, për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Organizimin e Eventeve* si dhe kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017639, për pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Marrëdhënie me Publikun*, në Departamentin e Informimit dhe Komunikimit me Publikun, të shpallura nga Zyra e Presidentës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Zyra e Presidentës së Kosovës, ndërsa, kjo e fundit ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale referuar çështjes në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorie administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 5138/2025, të datës 29.07.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference: RN00017594 të datës 08.04.2025; Kopjen e letërnjoftimit; Ftesën për testin me shkrim të datës 12.06.2025; Njoftimin nga Simbnj të datës 30.06.2025; Njoftimin e datës 01.07.2025; Njoftimin e datës 04.07.2025; Formularin e parashtrimit të ankesës së datës 29.07.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të dorëzuar nga organi i punësimit së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Kërkesën për fillimin e rekrutimit (punësimit) të datës 07.09.2025 nga ZKA, F.M; Listën e aplikantëve; Njoftimin për verifikim paraprak të datës 23.05.2025; Renditjen përfundimtare nga Simbnj të datës 03.07.2025; Njoftimin (listën përfundimtare të kandidatëve) të datës 04.07.2025; Vendimin Nr.76/2025 të datës 10.06.2025; Akt emërimit Nr.20/2025 të datës 02.04.2025; Akt emërimit Nr.02/111-546-01/25 të datës 29.04.2025; Akt emërimit Nr.02/11-420-01/05, të datës 28.03.2025; Akt emërimit me Nr.02/11-425-01/2025, të datës 01.04.2025; Akt emërimit me numër Nr.02/11-377-01/2025, të datës 25.03.2025; Kërkesën e datës 22.09.2025; Testin me shkrim të datës 25.06.2025; Aplikacionin me datë aplikimi 05.05.2025, të kandidatës E.B, së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 09.04.2025, të kandidatit Sh.R, së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Ftesën për test me shkrim të datës 12.06.2025; Ftesën për intervistë me gojë të datës 01.07.2025; Pyetjet e intervistës me gojë të datës 03.07.2025; Formularët e vlerësimit individual të anëtarëve të Komisionit të Pranimi në intervistë me gojë të datës 03.07.2025; Testin me shkrim të kandidatit fitues; Konkursin me numër reference RN00017693, të datës 16.04.2025; Njoftimin për rezultatet përfundimtare për konkursin me nr.ref:RN00017693, të datës 08.07.2025; Renditjen përfundimtare të kandidatëve nga Simbnj, Vendimin me numër protokolli Nr.1337 dhe numër Nr.235/2020, të datës 16.12.2020, të u.d.Presidentës së Kosovës (per emerimin e u.d.Sekretarit të Zyres së Presidencës).

I. Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit lidhur me konkursin me numër reference RN00017594, për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Organizimin e Eventeve, në Departamentin e Protokollit është e bazuar, sepse:

Gjendja e çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- Zyra e Presidentes së Kosovës më datë 08.04.2025, ka shpallur konkursin me numër reference RN00017594, për Grupin e Protokollit, pozita e punës Zyrtar i Lartë për Organizimin e Eventeve, në Departamentin e Protokollit, një 1 (një) vend i lirë pune, me klasë të pozitës Profesional 1, dhe afat të aplikimit 09.04.2025 deri 08.05.2025
- Ankuesja ka aplikuar në këtë konkurs, ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe njëkohësisht i është nënshtruar edhe testit me shkrim, në atë mënyrë që ka arrit 46 pikë, pra ankuesja nuk ka arrite pikët e mjaftueshme në asnjërën nga procedurat e rekrutimit për të vazhduar me fazat tjera të vlerësimi, gjegjësisht intervistës me gojë.
- Më datë 04.07.2025, Udhëheqësja e Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ka publikuar rezultatet përfundimtare lidhur me konkursin me numër reference RN00017594, për pozitën Zyrtar i Lartë për Organizimin e Eventeve, sipas të cilit njoftim rezulton se dy (2) kandidatë kanë arritur mbi 70 pikë, F.K me 76.4 pikë dhe Sh.R me 74.6 pikë.

Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton konkursin me numër reference RN00017594, mbi pretendimin ankimor se vlerësimi i testit me shkrim nuk është bërë si duhet. Tutje shton se ka kërkuar edhe nga njësia përgjegjëse e organit përkatës të punësimit për rishikimin e testit me shkrim, por sipas ankuses e njëjta nuk ka pranuar ndonjë përgjigje vetëm ka pranuar e-mailin me automatizëm të datës 04.07.2025, nga sistemi ku është njoftuar përsëri me pikët përfundimtare. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar duke detyruar organin e punësimit që ti japin dëshmitë e bazuara lidhur me vlerësimin e testit me shkrim.

Vlerësimi i Kolegjit

Në kuptim të statusit juridik të zyrtareve të Zyrës së Presidencës, Kolegji iu referua Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me theks të veçantë:

- Nenit 1 : Ky ligj ka për qëllim rregullimin e marrëdhënies së punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës, përkatësisht përcaktimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë pranimin, klasifikimin e pozitave, ndryshimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, të drejtat dhe detyrimet në raport me marrëdhënien e punës, si dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës.
- Nenit 2, paragrafi 3: Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për aq sa nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar më Kushtetutë.

-Nenit 6 i ndryshuar me nenin 6 të Ligjit Nr.08/L-294 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyratet Publik: *3.Të punësuarit e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, institucioneve të pavarura kushtetuese dhe agjencive të pavarura janë nëpunës civilë me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë.*

Bazuar në kuadrin ligjor si me sipër të punësuarit e Presidencës së Kosovës janë nëpunës civil me status të veçantë dhe së marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me akt të veçantë ligjor, e në këtë kontest Kolegji thekson faktin së çështjet lidhur me marrëdhënien e punës në Presidencës e Kosovës janë të rregulluara me këto akte të veçanta ligjore si Ligjin Nr.03/L-094 Për Presidentin Republikës së Kosovës, Rregulloren (P) Nr. 01/2025 Për Procesin e Rekrutimit të Sekretares/it të Zyrës së Presidentes/it, Rregulloren (P) Nr. 02/2022 Për Organizimin dhe Funksonimin e Presidencës, si dhe Udhëzimin Administrativ (Szp) Nr. 03/2024 Për Klasifikimin e Pozitave në Shërbimin Civil në Presidencë, akte këto që janë marrë për bazë për vendosje të kësaj çështje juridike-administrative në ndërlidhje në Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyratet Publikë.

Ndërsa në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe nisur nga mandati kushtetues i Këshillit lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, Kolegji në kuptim të autorizimit ligjor sipas nenit 86, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, ka shqyrtuar në vështrim të ligjshmërisë veprimet procedurale të ndërmarra në procedurën e pranimit më numër reference RN00017594, rrjedhimisht, Kolegji ka konstatuar së proceduara e kundërshtuar ishte shpallur sipas autorizimit të ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Zyrës së Presidentes sipas shkresës të datës 07.04.2025 dhe së vlerësimi profesional i kandidateve është bërë nga Komisioni ad hoc i pranimit i themeluar sipas Vendimit nr.76/2025 numër protokolli 02/11-738-01/25, të datës 10.06.2025, të ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Zyrës së Presidentes (tutje ZP-së)

Andaj, duke qenë së pozita e Sekretarit të ZP-së, ushtrohet më ushtrues të detyrës, Kolegji fillimisht konstaton faktin së Sekretari i ZP-së është Zyrtari më i lart administrativ siç përcaktohet me nenin 15.1 të Ligjit Nr.03/L-094 për Presidentin Republikës së Kosovë dhe pas konstatimit së legjislacioni në fuqi për Presidencën nuk ka rregulluar institutin e ushtrimit të përkohshëm të një pozite të lirë drejtues, atëherë, në trajtimin e drejt të çështjes së kompetencës ligjore të Sekretarit të ZP-së vije në zbatim përcaktimi ligjor sipas nenit 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyratet Publik.*(pasi që veprimet procedurale të ndërmarra nga Sekretari i Zyrës së Presidentes në këtë procedurë kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Ligjit NR. 08/L-294 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyratet Publik).* Rrjedhimisht, në këtë kontekst, Kolegji iu referua nenit 35 Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyratet Publikë, me të cilin është përcaktuar se : *1.Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë ë pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. 3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) mujor, ky afat mund të zgjas më së shumti*

edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm”, andaj, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji bazuar në provat materiale ka vërtetuar se pozita e Sekretarit të ZP-së është mbuluar me ushtrues detyre në një periudhë kohore prej më shumë se katër (4) vitesh, gjegjësisht, pozita e Sekretarit të ZP-së ka vazhduar të ushtrohet me ushtrues detyre sipas Vendimit Nr.prot:1337, të datës 16.12.2020, të Presidentes së Republikës së Kosovës, dhe mbi këtë bazë, rezulton fakti se pas hyrjes në fuqi të Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë më datë 25 shtator 2023 e njëjta pozitë ka qenë duke u ushtruar me ushtrues detyre prej më shumë se (1) një viti, gjegjësisht prej një (1) viti e gjashtë (6) muaj, deri në momentin e autorizimit për shpallje të konkursit.

Nisur nga gjendja e fakte si më sipër konstatohet se pozita e Sekretarit të ZP-së është ushtruar me tejkalim të afatit ligjor të përcaktuar me nenin 35 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe si pasojë autorizimi për shpalljen e procedurës më numër reference RN00017594 sipas shkresës të datës 07.04.2025 dhe Vendimi 76/2025, i datës 10.06.2025, për themelimin e Komisionit të Pranimit, janë të akte të paligjshme sepse cilësohen si veprime të ndërmarra në mungesë të kompetencës ligjore dhe si të tilla në tërësinë e saj cenojnë ligjshmërinë e procedurës së kontestuar, kështu që, mbi këto rrethana ligjore procedura më nr.ref: RN00017594, konsiderohet si procedurë e paligjshme në kuptim të nenit 52, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Për më tepër, Kolegji i Këshillit mori parasysh konstatimet e Gjykatës Supreme sipas aktgjykimit P.A.nr.07/2025 të datës 10.06.2024,(i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 03.07.2024) lidhur me interpretimin dhe efektet juridike të nenit 35 të Ligjit Nr.08/L-198 për Zyrtarët Publik, rrjedhimisht, Gjykata Supreme përmes kiji aktgjykimi ka konstatuar se: “ ***Nga kjo dispozite rrjedhë qartë se çdo akt juridik i nxjerrë nga një udhëheqës në cilësinë e ushtruesit të detyrës pas skadimit të afatit prej një viti është i pavlefshëm në thelb, për shkak të mungesës së kompetencës ligjore për të ushtruar funksionet që burojnë nga ajo pozitë..... Ligji i referohet pozitës si funksion institucional dhe jo individit si person. Pra ndërrimi i personit nuk e dhe nuk e rifillon afatin gjashtëmuor, përkatësisht njëvjeçar të ushtrimit të përkohshëm të pozitës. Kjo qasje është në përputhje me frymën e ligjit që kërkon, stabilitet, profesionalizëm dhe përgjegjësi në udhëheqjen publike...,***

Thënë si më lartë, Kolegji vendosi si në pikën I të dispozitivit, ashtu që, aprovoj si të bazuar ankesën lidhur me procedurën e pranimit më numër reference: RN00017594, pozita e punës, Zyrtar i Lartë për Organizimin e Eventeve, Zyra e Presidentes së Kosovës duke anuluar në tërësi procedurën si të paligjshme.

II. Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se objekti i ankesës së ankuesit lidhur me konkursin me Nr. Ref: RN00017639, për pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Marrëdhënie me Publikun, është bërë i pamundur, sepse:

Nga shkresat e lëndës del se Zyra e Presidentes së Kosovës më datë 16.04.2025, ka shpallur konkursin me numër reference RN00017639, për pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Marrëdhënie me Publikun, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesja, duke u përfshirë në listën e verifikimit paraprak, ashtu

që në testin më shkrim kishte akumuluar vetëm 47.6 pikë, si pikë të pamjaftueshme për të vazhduar me fazat tjera të vlerësimi, gjegjësisht intervistës me gojë. Më datë 08.07.2025, Udhëheqësja e Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare lidhur me konkursin me numër reference RN00017639, për pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Marrëdhënie me Publikun, sipas të cilit njoftim rezultoi se katër (4) kandidatë kanë arritur mbi 70 pikë dhe atë: Sh.B më 80.4 pikë, Q.M më 77 pikë, B.D më 74.4 pikë dhe T.B më 71.2 pikë. Ankuesja ka kontestuar këtë procedurë për paligjshmëri në procedurën e vlerësimit përmes testit më shkrim.

Duke qenë së kandidatja T.B, ka kontestuar më ankesë procedurën e rekrutimit me Nr. Reference: RN00017639, Këshilli më Vendimin me numër A.nr.1533/2025, të datës 30.09.2025, kishte anuluar në tërësi procedurën e pranimit më Nr. Ref: RN00017639. Andaj, marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1503/2025, të datës 07.08.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore, rrjedhimisht, ka anuluar në tërësi këtë procedurë, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*, Kolegji vlerëson së objekti i ankesës A.nr.1503/2025, lidhur me procedurën me Nr. Ref: RN00017639, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1503/2025, të datës 07.08.2025 lidhur me konkursin me Nr. Ref: RN00017639.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.1503/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses E.B;
- Zyrës së Presidentes së Kosovës: Sekretarit dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore;
- Arkivit të KPMSHCK-së